

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6838  
E enjte, 2 mars 2023  
çmimi 0.40 €

Mavraj për planin evropian: U avullua njohja, dëm historik dhe tragjik, por jo i papritur | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AVIONËT NGA KOSOVA DO TË FLUTUROJNË 'SË SHPEJTI' PËRMES SHQIPËRISË | FAQE 4-5



Që nga paslufta, më 1999, fluturimet nga dhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës realizohen vetëm përmes korridorit ajror që e lidh Kosovën me Maqedoninë e Veriut. Marrëveshja

me Shqipërinë, për ta shfrytëzuar korridorin ajror të këtij vendi, është arritur në vitin 2020. Marrëveshja nuk është zbatuar për shkak të disa procedurave teknike që është dashur të miratohen nga Shqipëria dhe

misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR. Bujar Ejupi, drejtor i përgjithshëm i AAC-së, thotë se KFOR-i e ka dhënë lejen për shfrytëzimin e pikave Kukud dhe Arbër dhe se ato pritet të lëshohen në shfrytëzim "së shpejti"

### KURTI: NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE ME SERBINË MUND TË BËHET ME NJOHJE TË NDËRSJELLË | FAQE 5



### SHTYHET HYRJA NË FUQI E ETIAS-it, LIBERALIZIMI I VIZAVE JO MË VONË SE 1 JANAR 2024 | FAQE 5



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



TË PAKTËN 36 PERSONA TË VDEKUR NGA PËRPLASJA E TRENAVE NË GREQI | F. 2

LB-JA: PROPOZIMI EVROPIAN, NJË MARRËVESHJE QË E LARGON EDHE MË TEPËR ZGJIDHJEN | F. 7

DITA NDËRKOMBËTARE E PËRDORUESVE TË KARROCËS, BËHET THIRRJE PËR KUJDES NDAJ PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR | F. 7

### EKONOMI



HYN NË FUQI LIGJI I RI GJERMAN PËR ZINXHIRËT E FURNIZIMIT, PREK EDHE KOMPANITË NGA KOSOVA | F. 8

ÇMIMET VAZHDOJNË TË BIEN NGADALË NË EVROPË | F. 8

### SPORT



MURIQI: DUA TA NDIHMOJ SPANJËN TË NA NJOHË SI SHTET | F. 10

## Të paktën 36 persona të vdekur nga përplasja e trenave në Greqi

**ATHINË, 1 MARS** - Një tren me pasagjerë është përplasur me një tren mallrash në veri të Greqisë, duke lënë të vdekur 36 persona, ndërsa të paktën 85 janë plagosur.

Zyrtarët e spitalit në qytetin e afërt Larisa kanë thënë se të paktën 25 persona kanë lëndime serioze.

Aksidenti ka ndodhur në qytetin Tempe pak para mesnatës.

Disa pjesë të trenit kanë dalë nga binarët dhe kanë marrë flakë.

Treni me rreth 350 pasagjerë ka qenë duke udhëtuar nga Athina për në qytetin verior Selanik.

Presidentja greke, Katerina Sakellariopoulou, e ka



ndërprerë vizitën në Moldavi, për t'u kthyer në vendin e saj. Të mbijetuarit kanë thënë se shumë pasagjerë kanë dalë nga dritaret për shkak të presionit të

lartë. "Ka pasur shumë pjesë të mëdha të çelikut", ka thënë Vassilis Polyzos, banor lokal që ka shkuar menjëherë në skenën e aksidentit. "Trenat janë

shkatërruar plotësisht".

Ekipet e shpëtimit kanë punuar gjithë natën për të gjetur të mbijetuarit. "Kemi dëgjuar një shpërthim të madh", ka thënë pasagjeri 28-vjeçar Stergios Minenis, i cili ka dalë nga treni. "Kemi rënë në krah derisa vagoni është ndalur. Ka pasur shumë panik. Kablo, zjarr. Zjarri ka shpërthyer menjëherë. Zjarr ka pasur në të gjitha anët", është cituar të ketë thënë Minenis, sipas agjencisë së lajmeve "Reuters". "Për 10, 15 sekonda ka qenë kaos. Njerëzit duke u rrotulluar, kablo të varura, dritare të thyera, njerëzit duke bërtitur". Një pasagjer ka thënë për televizionin Skai se "dritaret

kanë shpërthyer menjëherë" dhe "njerëzit kanë qenë të frikësuar". "Fatmirësisht, ne kemi arritur t'i hapim dyert dhe të ikim shpejt. Edhe në vagonët e tjerë njerëzit kanë arritur të dalin, dhe njërin e kanë marrë flakët".

Pasagjeri tjetër, Angelos Tsiamouras, u ka thënë medieve lokale se shpërthimi është ndier si tërmet, derisa një tjetër, me emrin Lazos, i ka thënë gazetës "Protothema", se nuk ka qenë i plagosur, por "i mbuluar me gjak nga njerëzit e tjerë që kanë qenë afër". Ekipet e shpëtimit kanë thënë se situata ka qenë tepër e rëndë. Shkaku i përplasjes nuk dihet ende.

## Finlanda nis ndërtimin e gardhit në kufi me Rusinë

**HELSINKI, 1 MARS** - Finlanda ka nisur të ndërtojë një gardh kufitar prej 200 kilometrave në kufi me Rusinë për ta rritur sigurinë.

Garda Kufitare ka thënë se gardhi do të jetë tri metra, me tela gjemborë në krye.

Finlanda është vendi i Bashkimit Evropian që ndan kufirin më të gjatë me Rusinë - 1 340 kilometra.

Aktualisht kufijtë e Rusisë sigurohen vetëm përmes një

gardhi të lehtë prej druri.

Finlanda ka vendosur ta ndërtojë mbrojtjen e re, pas rritjes së numrit të rusëve që duan t'i ikin rekrutimit në vendin e tyre për të luftuar në Ukrainë.

Ky shtet nordik, po ashtu, është duke iu afruar anëtarësimit në NATO.

Pas nisjes së luftës në Ukrainë, më 24 shkurt të vitit të kaluar, Finlanda dhe Suedia kanë vendosur t'i bashkohen aleancës

veriatlantike sa më shpejt që është e mundur, duke i dhënë fund qasjes neutrale.

Mirëpo Helsiniki përballet me më pak probleme diplomatike sesa Stokholimi, pasi qeveria finlandeze dëshiron të ecë përpara para zgjedhjeve të përgjithshme që mbahen në Finlandë në muajin prill.

Vetëm Turqia dhe Hungaria ende nuk i kanë ratifikuar aplikimet e Finlandës dhe Suedisë për t'u anëtarësuar në NATO.



## Danimarka shfuqizon një festë publike për ta rritur buxhetin në mbrojtje



**KOPENHAGE, 1 MARS** - Parlamenti i Danimarkës ka votuar për shfuqizimin e një feste në pranverë për ta rritur buxhetin për ushtrinë.

Ligjvënësit kanë votuar me 95 vota për dhe 68 kundër për mosfestimin e "Ditës së Lutjes së Madhe", një festë fetare, e cila shënohet prej shekullit 17.

Anulimi do t'i shtojë buxhetit shtetëror 427 milionë dollarë, që do të shfrytëzohen për mbrojtje, ka thënë qeveria daneze. Mirëpo ky vendim

është kundërshtuar nga politikanët opozitarë, sindikatat e punëtorëve dhe figurat fetare. Ditë më parë rreth 50 000 protestues janë mbledhur jashtë parlamentit në Kopenhagë për të protestuar rreth planit. "Ndaleni hajninë", ka thënë Karsten Hønge, anëtar i Partisë Socialiste Popullore gjatë debatit parlamentar. "Qeveria është duke urdhëruar njerëzit që të punojnë një ditë më shumë".

Pavarësisht prej kundërshtimeve,

koalicioni qeveritar në Danimarkë ka thënë se paratë shtesë janë të nevojshme për t'i rritur shpenzimet për buxhetin e NATO-s.

Sipas qeverisë, këto ndryshime janë pasojë e luftës së Rusisë në Ukrainë.

Popullsia e Danimarkës i ka 11 ditë pushimi për festat publike. "Nuk mendoj se është problem që të punohet një ditë më shumë", ka thënë kryeministrja daneze Mette Frederiksen.

## Erdogani: Zgjedhjet do të mbahen në maj, pavarësisht tërmetit

**ANKARA, 1 MARS** - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan e ka hedhur poshtë mundësinë e shtyrjes së zgjedhjeve pas tërmeteve shkatërruese të muajit shkurt. Sipas presidentit turk, zgjedhjet do të mbahen më 14 maj. "Populli turk do ta bëjë atë që duhet më 14 maj", u ka thënë ai

ligjvënësve në Parlamentin e Ankarasë.

Lideri turk e ka propozuar më parë datën 14 maj për zgjedhje dhe shpreson që qeveria e tij do të mbesë në pushtet deri më 2028. Por, pas tërmeteve masive që kanë lënë të vdekur më shumë se 45 000 njerëz në Turqi, ka pasur dilema nëse

votimet do të mbahen siç është planifikuar.

Erdogani ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme për tre muaj në 11 provincat e goditura nga tërmetet. Ky rajon është duke u përballur me pasgoditje të fuqishme, duke e bërë pothuajse të pamundshme fushatën në atë zonë.



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere\_mm@hotmail.com & mm\_epokaere@yahoo.com

# Mavraj për planin evropian: U avullua njohja, dëm historik dhe tragjik, por jo i papritur



**PRISHTINË, 1 MARS (ER)** - Publicisti Muhamet Mavraj ka komentuar planin evropian për të cilin kanë arritur pajtueshmëri kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vučić, në Bruksel.

Mavraj ka thënë se me pranimin e këtij plani "njohja de jure dhe madje de facto më nuk janë kokëçarje për Serbinë". Ndërsa duke folur për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, i cili është brenda planit, Mavraj ka thënë se Kosova ka pranuar autonomi për komunat e udhëhequra nga serbët. "Asociacioni (...) kishte dy frena: një të brendshëm, Gj. KUSHTETUESE, dhe një të jashtëm, GARANCIONIN zyrtar të BE-së se ky asociacion nuk do të ketë kompetenca ekzekutive, (Mogerini për Mustafën). Këto pra i kemi! Pse të kërkohen kur i kemi?

Po kërkojnë çfarë kanë pështyrë për 10 vjet. Kanë një hall këta: në Bruksel kanë dhënë pajtim për pushtet shumë më të madh sesa asociacioni, autonomi vetëmenaxhuese, që edhe po t'u jepet në këmbim, nuk marrim dorëheqjen e Serbisë nga Kosova në të ardhmen. Sa për statusin e Kishës serbe, nuk po zgjatemi këtu, por do ta harrojmë atë Abazoviqin kur shohim çfarë po pillet këtu nga tinëzaria tradicionale", ka shkruar Mavraj në "Facebook".

## Postimi i plotë i Mavrajt:

Njohja de jure dhe madje de facto më nuk janë kokëçarje për Serbinë. U avullua njohja, madje edhe në letrat e miqve amerikanë në kohën kur në Shtëpinë e Bardhë kemi mikun më të madh

të mbetur nga të gjallët. Dëm historik! Dëm tragjik, por jo i papritur! Shpesh kemi folur për këtë çështje këtu me ju miq, në 3-4 vitet e ikura.

Me bëri njëfarë përshtypje rënia nga 6 kushtet e kota për asociacionin në tri të kota, retorike, dje, para publikut vendor, të cilin, ky klubi i stanit, po e mendon në nivel bagëtie. Gabohet rëndë!

## Shkurtimisht:

Asociacioni (...) kishte dy frena: një të brendshëm, Gj. KUSHTETUESE, dhe një të jashtëm, GARANCIONIN zyrtar të BE-së se ky asociacion nuk do të ketë kompetenca ekzekutive, (Mogerini për Mustafën). Këto pra i kemi! Pse të kërkohen kur i kemi? Po kërkojnë çfarë kanë

pështyrë për 10 vjet. Kanë një hall këta: në Bruksel kanë dhënë pajtim për pushtet shumë më të madh sesa asociacioni, autonomi vetëmenaxhuese, që edhe po t'u jepet në këmbim, nuk marrim dorëheqjen e Serbisë nga Kosova në të ardhmen.

Sa për statusin e Kishës serbe, nuk po zgjatemi këtu, por do ta harrojmë atë Abazoviqin kur shohim çfarë po pillet këtu nga tinëzaria tradicionale.

## Nuk jemi bagëti!

Marrëveshja e Brukselit mbyll përgjithmonë mundësinë e zgjidhjes së konfliktit Kosovë - Serbi. E përsëris: përgjithmonë! Ngrihet! Për këtë ngrirje investoi shumë Serbia, këtu e kahmos. Në rastin e parë të volitshëm ajo ruan të drejtën e kthimit në Kosovë, në të

ardhmen, sepse në të tashmen askund nuk heq dorë nga Kosova. Tapinë për vete, ti grahi makinës kah të lejohet. Nuk lëviz legjislacioni i saj i brendshëm nga letrat e Brukselit, pra as Kushtetuta serbe, madje as emrin zyrtar të Kosovës nuk detyrohet ta njohë (pavarësisht prej simboleve, letërnjoftimeve e të tjera të nënshkruara vite më parë, përfshirë pasaportat në aeroport, diplomat etj.).

Ndërkohë, spastrimi etnik i Kosovës po vazhdon vullshëm dhe çdo ligj a politikë e re e këtij klubi qeverisës po e përshpejton largimin e shqiptarëve nga Kosova! Megjithatë, shpresa të mos humbet kurrë!

*(Të drejtën e botimit ia jap "Epokës së re". Miqtë janë të lirë ta komentojnë e shpërndajnë në profilet e tyre)*

## Bideni e fton Osmanin në samitin e dytë për demokraci

**PRISHTINË, 1 MARS** - Presidenti amerikan Joe Biden e ka ftuar presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, në samitin e dytë për demokraci. Samiti do të mbahet më 29-30 mars në formatin virtual, me mbi 100 vende pjesëmarrëse.

Ky samit është themeluar me iniciativë të presidentit Biden dhe edicioni i parë është

mbajtur në dhjetor të vitit 2021.

Kosova është ftuar edhe në herën e parë.

Sipas Presidencës së Kosovës, Osmani është zgjedhur në mesin e dhjetë liderëve që të jenë folëse në seancën plenare, në të cilën do të diskutohet për rolin e demokracisë për krijimin e

institucioneve stabile.

Në këtë takim, sikur edhe në të parin, do të diskutohet për rëndësinë e demokracisë dhe se si shtetet t'i adresojnë më së miri sfidat globale.

Presidenti amerikan Joe Biden pati thënë në samitin e parë se "bota është në vitet e para të një dekade vendimtare për të ardhmen kolektive".





# Avionët nga Kosova do të fluturojnë 'së shpejti' përmes Shqipërisë

Që nga paslufta, më 1999, fluturimet nga dhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës realizohen vetëm përmes korridorit ajror që e lidh Kosovën me Maqedoninë e Veriut. Marrëveshja me Shqipërinë, për ta shfrytëzuar korridorin ajror të këtij vendi, është arritur në vitin 2020. Marrëveshja nuk është zbatuar për shkak të disa procedurave teknike që është dashur të miratohen nga Shqipëria dhe misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR. Bujar Ejupi, drejtor i përgjithshëm i AAC-së, thotë se KFOR-i e ka dhënë lejen për shfrytëzimin e pikave Kukad dhe Arbër dhe se ato pritet të lëshohen në shfrytëzim "së shpejti".

**PRISHTINË, 1 MARS** - Koha e fluturimit me avion nga Kosova drejt shteteve të Bashkimit Evropian dhe anasjelltas do të shkurtohet në rast të hapjes së korridorit ajror me Shqipërinë. Me shkurtrimin e kohës - deri në 30 minuta për vajtje-ardhje - do të zvogëlohet edhe çmimi i biletave, thotë për "Radion Evropa e Lirë" Albion Idrizi, magjistër i aviacionit. Aktualisht, thotë ai, çmimi mestar i një bilete njëdrejtimeshe nga Kosova për në të gjitha vendet e BE-së është 140 euro. Me shkurtrimin e fluturimit, ky çmim mund të bjerë deri në 6 për qind, apo 8 euro, thotë Idrizi, ndërmarrës në fushën e udhëtimeve dhe turizmit në Kroaci dhe Kosovë.

Që nga paslufta, më 1999, fluturimet nga dhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës realizohen vetëm përmes

korridorit ajror që e lidh Kosovën me Maqedoninë e Veriut. Marrëveshja me Shqipërinë, për ta shfrytëzuar korridorin ajror të këtij vendi, është arritur në vitin 2020. Kjo marrëveshje ka paraparë hapjen e dy pikave koordinuese ajrore, Kukad dhe Arbër, por nuk është zbatuar kurrë.

Sipas Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (AAC), i cili menaxhon hapësirën e ulët ajrore të vendit, marrëveshja nuk është zbatuar për shkak të disa procedurave teknike që është dashur të miratohen nga Shqipëria dhe misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR.

Bujar Ejupi, drejtor i përgjithshëm i AAC-së, thotë se KFOR-i e ka dhënë lejen për shfrytëzimin e pikave Kukad dhe Arbër dhe se ato pritet të lëshohen në shfrytëzim "së shpejti".

KFOR-i, i cili është përgjegjës për sigurinë e hapësirës ajrore të Kosovës, konfirmon për "Radion Evropa e Lirë" se "ka miratuar mundësinë e hapjes së korridoreve ajrore ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë", por nuk jep shumë hollësi. "Pikat Kukad dhe Arbër janë në territorin shqiptar, kështu që institucionet e aviacionit të atij vendi janë autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe menaxhimin e asaj hapësire ajrore", thuhet në deklaratën e KFOR-it.

REL-i pyeti Agjencinë Nacionale të Trafikut Ajror të Shqipërisë, Albcontrol, se cilat janë arsyet e mosplanifikimit të fluturimeve përmes Kukadit dhe Arbërit deri më tash dhe kur saktësisht pritet të lëshohen në shfrytëzim këto dy pika, por nuk mori përgjigje.

Me të njëjtat pyetje, REL-i iu drejtua edhe Organizatës Evropiane për Sigurinë e Navigacionit, Eurocontrol, e cila në përgjigje tha se "përgjegjësia për krijimin dhe shpalljen e pikave të navigacionit i takon shtetit përkatës [v.] në këtë rast Shqipërisë" dhe jo Eurocontrol-it". Ejupi nga AAC-ja pret që dy pikat koordinuese, Kukad dhe Arbër, të shenjëzohen shpejt në hartat e Eurocontrol-it, por nuk jep ndonjë datë të saktë. Pas finalizimit të kësaj procedure, ai beson se të gjitha kompanitë ajrore që operojnë në tregun e Kosovës do t'i shfrytëzojnë këto dy pika.

## Përfitimet nga korridoret e reja ajrore

Remzi Ejupi, themelues i kompanisë ajrore të Kosovës "Eurokoha", e cilëson si "jashtëzakonisht të rëndësishëm" korridorin ajror me Shqipërinë. Ngjashëm sikurse Idrizi, edhe ai thotë se koha e fluturimeve drejt vendeve të BE-së do të shkurtohet për së paku gjysmë ore. "Të shkurtohet rruga për këto minuta, zvogëlohen [edhe] shpenzimet për karburante dhe kjo automatikisht ul çmimin e biletave", thotë Ejupi për "Radion Evropa e Lirë".

Vitin e kaluar për dhe nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" kanë udhëtuar rreth tre milionë qytetarë, me 21 842 fluturime. Zvicra, Gjermania, Turqia, Austria dhe Mbretëria e Bashkuar kanë qenë destinacionet më të shpeshta.

Idrizi thotë se korridori ajror me Shqipërinë do ta bëjë Aeroportin e Prishtinës "më konkurrent në rajon" dhe "më joshës për kompanitë ajrore" për shkak të koston më të ulët të operimit. Ai thotë se Kosova duhet të hapë korridor ajror edhe me Malin e Zi për shkak të pozitës gjeografike që ka ky shtet. "Korridori me Malin e Zi është edhe më i rëndësishëm se me Shqipërinë, pasi që ky shtet kufizohet me

pjesën veriperëndimore të Kosovës, pra në drejtim të Gjermanisë dhe Zvicrës, që janë destinacionet me të cilat kemi më së shumti trafik ajror. Shkurtimi për çdo fluturim do të ishte 20 minuta në një drejtim", thotë Idrizi për Radion Evropa e Lirë.

Drejtori i AAC-së, Ejupi, thotë se bisedimet me Malin e Zi për këtë çështje janë në zhvillim e sipër, por se "ende nuk ka diçka konkrete".

Korridori ajror me Serbinë - vend tjetër me të cilin kufizohet Kosova - është pezulluar qysh pas luftës më 1999. Edhe pse ka pasur paralajmërime se në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi do të bisedohet për hapjen e këtij korridori, një gjë e tillë nuk ka ndodhur ende.

Ndryshe nga hapësira e ulët ajrore e Kosovës që menaxhohet nga AAC-ja, hapësira e lartë - ajo mbi 6 200 metra, e hapur për trafikun komercial nga viti 2014 - është nën kontrollin e Hungarisë, përkatësisht të Hungaro Control-it, për shkak se Kosova nuk ka arritur ende kapacitete për ta menaxhuar hapësirën e lartë ajrore.

Në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, por edhe me ligjet e tanishme në Kosovë, komandanti i KFOR-it është përgjegjës për sigurinë e hapësirës ajrore të Kosovës që nga viti 1999.

# Kurti: Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë mund të bëhet me njohje të ndërsjellë

PRISHTINË, 1 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën se Kosova është rrëfim suksesi dhe vend normal demokratik, por marrëdhëniet me Serbinë nuk i ka normale. "Duhet t'i normalizojmë marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve dhe besoj se normalizimi i marrëdhënieve mund të bëhet me njohje të ndërsjellë si pjesë qendrore. Kjo është thënë nga presidenti [amerikan, Joe] Biden, nga sekretari [amerikan i Shtetit, Antony] Blinken, kancelari

[gjerman, Olaf] Scholz, që njohja e ndërsjellë është pjesa thelbësore për normalizim të plotë të marrëdhënieve, për çka jemi duke punuar me shumë zell", ka thënë Kurti në Forumin Ekonomik që është duke u mbajtur në Shkup.

Ai ka përmendur se si Kosova ashtu edhe Serbia e kanë pranuar propozimin e Bashkimit Evropian për normalizim të marrëdhënieve më 27 shkurt. "E kemi miratuar në të dyja kryeqytetet dhe pastaj edhe në Bruksel".

Në fund të takimit të 27 shkurtit

në Bruksel, Bashkimi Evropian ka thënë se palët kanë shprehur gatishmëri për ta vazhduar zbatimin e planit të BE-së.

Takimi i radhës në mes të kryeministrit Kurti dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiq pritet të mbahet gjatë këtij muaji. "Mos të harrojmë që më 9 qershor të vitit 1999 në Kumanovë është nënshkruar kapitullimi i Jugosllavisë së [ish-liderit serb, Slobodan] Millosheviqit dhe hyrja e forcave të NATO-s. Mendoj se këto elemente simbolike të Maqedonisë së

Veriut kanë qenë shumë të rëndësishme për [kryediplotmatin evropian, Josep] Borrell, që të na ftojë në Maqedoni [të Veriut] për takimin e radhës të nivelit të lartë", ka thënë Kurti.

Propozimi evropian u është dorëzuar palëve fillimisht në vjeshtën e vitit 2022.

Ky propozim parashihet t'i drejtojë palët drejt një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse. Propozim-marrëveshja që është bërë publike pas takimit, përfshin zotimin e palëve për t'i respektuar të gjitha marrëveshjet e arritura

deri më tani në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, si dhe përkushtimin e tyre për të mos e penguar njëra-tjetrën në proceset integruese.

Marrëveshjet e deritashme përfshijnë edhe atë për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, e cila është arritur në vitin 2013, por nuk është zbatuar kurrë. Kurti thotë se në Kosovë nuk mund të ketë asociacion njëetnik me kompetenca ekzekutive, ndërsa Vuçiqi insiston në themelimin e tij.



## Shtyhet hyrja në fuqi e ETIAS-it, liberalizimi i vizave jo më vonë se 1 janar 2024

PRISHTINË, 1 MARS - Bashkimi Evropian e ka shtyrë funksionalizimin e sistemit ETIAS për në vitin 2024, ndonëse ai është paraparë të hyjë në fuqi më 1 nëntor të këtij viti. Hyrja në fuqi e këtij sistemi është kthyer në temë të rëndësishme për qytetarët e Kosovës, sepse me të është lidhur liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës. Megjithatë, në vendimin për vizat për Kosovën është thënë se nëse sistemi ETIAS nuk hyn në fuqi deri në nëntor të këtij viti, liberalizimi i vizave për Kosovën do të hyjë në fuqi më 1 janar 2024. Në faqen e ETIAS-it nuk janë dhënë arsye për shtyrjen e këtij



vendimi.

Pikërisht mundësia e bllokimit të

procesit të vizave për Kosovën i ka shtyrë disa vende të BE-së që të

insistojnë për të pasur datë për këtë proces, edhe nëse do të ketë vonesa për ETIAS-in. Disa burime diplomatike i kanë thënë "Radios Evropa e Lirë" se qëndrimi që "jo më vonë se 1 janar 2024 nuk do të thotë se [liberalizimi] nuk mund të ndodhë më herët".

Kosova është vendi i vetëm i Ballkanit Perëndimor që nuk e gëzon lëvizjen e lirë me vendet e zonës Shengen.

### Si funksionon ETIAS?

ETIAS është sistem evropian për autorizim dhe informacione rreth udhëtimit. Ky sistem - krejtësisht elektronik - mundëson

verifikimin e të dhënave të qytetarëve të vendeve të treta, që nuk nevojë për vizë, për të hyrë në Zonën Schengen. Aty kërkohet emri, vendi i lindjes, gjinia, kombësia dhe secili që plotëson formularin duhet të ketë pasaportë, email dhe një kartelë krediti për të kryer pagesën simbolike për këtë dokument. Autorizimi për udhëtim lëshohet shpejt dhe në mënyrë automatike, përveç nëse ka dyshime për të kundërtën. Dokumenti valid ETIAS më pas rishikohet nga roja kufitare e shtetit, që merr vendimin final për hyrjen potenciale të udhëtarit në një vend të Zonës Schengen.

## PDK-ja: Nga marrëveshja finale me njohje në qendër, në marrëveshje të përkohshme me Asociacion në qendër

PRISHTINË, 1 MARS - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka mbajtur mbledhjen e kryesisë, në të cilën është diskutuar për zhvillimet e fundit politike.

Partia Demokratike e Kosovës e cilëson si mundësi të humbur për Republikën e Kosovës pranimin e propozimit evropian nga ana e kryeministrit Kurti, i cili dokument është i pamjaftueshëm për arritjen e qëllimeve shtetërore të vendit tonë. "Përmes pranimin të propozimit evropian, fatkeqësisht, ndodhi ajo që PDK kishte paralajmëruar disa herë gjatë javëve dhe muajve të fundit. Kryeministri Kurti hoqi dorë nga qëndrimet dhe kushtet e tij para interesave personale dhe ambicieve për të qëndruar në pushtet. Ndërkaq, si rrjedhojë, Kosova humbi njohjen e ndërsjellë me Serbinë, ndërsa fitoi Asociacionin e Komunave me shumicë serbe", ka njoftuar PDK-ja.

Për më shumë, sipas PDK-së, në propozimin zyrtar nuk flitet për njohjen nga pesë vendet

mosnjohëse të BE-së, nuk flitet për hapjen e rrugës drejt anëtarësimit në NATO, as për marrjen e statusit kandidat për anëtarësim në BE. Përkundrazi, aty flitet për kompetenca të zgjeruara për komunitetin serb, që rrezikojnë të çojnë drejt autonomisë substanciale dhe, po ashtu, flitet për statusin e veçantë për Kishën Ortodokse Serbe në Kosovë, që rrezikon të çojë drejt ekstra-territorialitetit. "Për dy vjet me radhë, Partia Demokratike e Kosovës e ka mbështetur kryeministrin Kurti në raport me Serbinë. PDK-ja e ka inkurajuar që të koordinohet me aleatët tanë ndërkombëtarë dhe i ka ofruar edhe propozime konkrete në lidhje me marrëveshjen finale me njohjen e ndërsjellë në qendër. Për fat të keq, kryeministri Kurti injoroi çdo ndihmë e këshillë që i është dhënë dhe kokë më vete e në kundërshtim me interesat afatgjatë të Republikës së Kosovës, përmes veprimeve dhe politikave të gabuara, degradoi pakthyeshëm procesin e dialogut.



Rrjedhimisht, ai mundësoi zëvendësimin e marrëveshjes finale me njohjen e ndërsjellë në

qendër me një marrëveshje të përkohshme me Asociacionin në qendër. Pikërisht, ashtu siç ka

synuar Serbia në këtë proces të dialogut", theksohet në njoftimin e PDK-së.

## Përurohët pavijoni i ri në Shërbimin Korrektues për persona me nevoja të veçanta

PRISHTINË, 1 MARS - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka marrë pjesë në ceremoninë e hapjes së "Pavijonit D" në Qendrën Korrektuese të Dubravës, në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Të pranishëm ishin ambasadori i ShBA-së, Jeffrey M. Hovenier dhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu.

Në fjalën e tij, ambasadori Hovenier tha se ky është një prej njësiteve të para për personat me nevoja të veçanta në rajon. "Programi për pavijonin për persona me nevoja të veçanta është jetësuar gjatë një trajnimit që kanë marrë pjesë zyrtarët e shërbimit korrektues dhe i cili është sponsorizuar nga Ambasada e ShBA-së. Meqë ky është programi i parë i kësaj natyre në rajon, Kosova po tregon qartazi se është shumë serioze për përmirësimin e programeve të veta korrektuese", ka theksuar Hovenier. Ministri i Shëndetësisë, Arben



Vitia, para të pranishmëve ka theksuar se ky proces nga Këshilli i Evropës promovohet si shembull i

mirë i funksionimit për t'i inkurajuar vendet e tjera për ta bërë të njëjtin veprim në dobi të

trajtimin ekuivalent të të burgosurve sikurse të gjithë qytetarëve të tjerë pa ndikim dhe

stigmatizime.

Ndërsa ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka pohuar se të gjithë njerëzit pa dallim, edhe ata të cilëve për një kohë u është hequr liria, kanë të drejtën e kujdesit shëndetësor, e drejtë e cila jo vetëm se nuk mund të mohohet, por edhe duhet të sigurohet e garantohet me çdo kusht.

Ky projekt është realizuar në bashkëpunim në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë me mbështetjen e Ambasadës Amerikane. Me anë të këtij projekti është bërë transferimi i shërbimeve shëndetësore për të burgosurit nga Ministria e Drejtësisë te Ministria e Shëndetësisë për të ofruar shërbime të barabarta për të gjithë qytetarët e vendit.

Vlera e këtij projekti është rreth gjysmë milioni euro, ndërsa si staf janë shtuar 30 oficerë të rinj dhe 14 pozita për profesionistë shëndetësorë.

## 49 raste të reja me Covid në 24 orët e fundit në Kosovë

PRISHTINË, 1 MARS - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë janë regjistruar 49 raste të reja të Covid-19. Numri i rasteve aktive është 236. "Ua rikujtojmë qytetarëve se vaksina kundër Covid-19 mbetet mënyra më e mirë dhe

efikase për ta parandaluar rritjen e rasteve të reja, për ta rivendosur imunitetin që mund të dobësohet me kalimin e kohës dhe për t'i evituar format e rëndë të sëmundjes", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë, e cila u ka bërë thirrje qytetarëve të vazhdojnë të vaksinohen me

dozën e radhës dhe dozën përfunduese të vaksinës kundër Covid-19. "Dozat përfunduese bivalente kundër Covid-19 janë në dispozicion dhe qytetarët mund të vaksinohen në njësinë më të afërt të vaksinimit në komunën e tyre", ka njoftuar MSH-ja.



# Dita Ndërkombëtare e Përdoruesve të Karrocës, bëhet thirrje për kujdes ndaj personave me aftësi të kufizuara

## “Epoka e re”

PRISHTINË, 1 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësues të organizatës “Handikos”, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Përdoruesve të Karrocës. Presidentja shprehu mbështetjen ndaj përdoruesve të karrocës dhe tha se institucionet e Kosovës kanë gatishmëri t'i mbështetin ata jo vetëm në ditë të shënuara, por gjatë tërë vitit. Në shenjë solidarizimi në Ditën Ndërkombëtare të Përdorimit të Karrocave, presidentja Osmani është ulur në karrocë duke përcjell mesazhin për gjithëpërfshirje të përdoruesve, përmirësim të qasjes si një e drejtë themelore njerëzore si dhe eliminim të pengesave. “Krijimi i mundësive për lëvizje të lirë për ju është obligim ynë. Gjithnjë është e mundur të bëjmë më shumë për këta persona. Kemi mbështetur vazhdimisht aktivitetet e organizatës ‘Handikos’, por edhe të fëmijëve e grave me nevoja të veçanta. Jemi në çdo ditë të vitit me ju dhe për mundësi të barabarta për të

gjithë”, ka theksuar presidentja Osmani.

Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur në një takim drejtuesit e Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “Handikos”. Drejtori i kësaj shoqate, Afrim Maliqi, e njoftoi Konjufcën në lidhje me aktivitetet e tyre, sfidat me të cilat përballen dhe pozitën sociale të personave me aftësi të kufizuara, duke kërkuar më shumë përkrahje institucionale për këtë kategori të shoqërisë sonë. Konjufca ritheksoi nevojën që institucionet qendrore dhe ato lokale, por edhe shoqëria jonë në përgjithësi, ta rritin kujdesin dhe investimet në krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara. Ai njëherësh shprehu mbështetje për t'u siguruar atyre mundësi të barabarta dhe jetë sa më të dinjitetshme.

Drejtesit e ‘Handikos’-it i ka pritur edhe kryeministri Albin Kurti. “Synimi i qeverisë është të ofrojë mundësi dhe qasje të barabarta për të gjithë, mundësi për pjesëmarrje aktive në shoqëri, lëvizje të lirë dhe jetë të dinjitetshme”, ka thënë Kurti.



Në takim u bisedua për procesin e Amandamentimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të iniciuar nga Zyra e Kryeministrit, për përfshirjen e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e

Personave me Aftësi të Kufizuara në Kushtetutë, konkretisht Neni 22. Duke folur për ndryshimet e nevojshme ligjore, u përmend miratimi i Udhëzimit Administrativ për caktimin e Listës, llojeve dhe pajisjeve

ndihmesë që ofrohen falas për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe procesi i hartimit të Projektligjit për Vlerësimin, Njohjen e Statusit, Përfitimet dhe Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuara.

## LB-ja: Propozimi evropian, një marrëveshje që e largon edhe më tepër zgjidhjen

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 1 mars - Lëvizja për Bashkim (LB) ka reaguar në lidhje me planin franko-gjerman dhe pajtimin që është arritur në mes të kryeministrit Albin Kurti dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiq në Bruksel.

LB-ja ka theksuar se propozimi evropian është një marrëveshje që e largon edhe më tepër zgjidhjen e problemit. “Pas zyrtarizimit të të ashtuquajturit plan franko-gjerman, opinioni publik pati mundësi ta shohë përmbajtjen e plotë dhe zyrtare të këtij propozimi. Në tërësinë e tij, ky propozim jo vetëm që nuk e trajton drejt problematikën në mes të Kosovës dhe Serbisë, por shkon edhe më tutje: plani e komplikon dhe kështu e vështirëson edhe më shumë zgjidhjen e problemeve reale të mbetura të pazgjidhura në mes të Kosovës dhe Serbisë si për nga



mënyra e trajtimit të pavarësisë së Kosovës, ashtu edhe për faktin se propozon zgjerim të mëtejshëm të privilegjeve për serbët e Kosovës dhe forcon

lidhjen legale të ‘komunitetit të vetëmenaxhuar’ me Serbinë”, thuhet në reagimin e LB-së, e cila drejtohet nga Valon Murati. Sipas LB-së, ajo që shërben si

mashtim i madh është pjesa e planit që flet për integrimet evropiane, duke e shmangur kërkesën për njohje të Kosovës nga Serbia në tërësi. “Për të qenë

edhe më e rëndë pesha e dëmit nga plani, edhe në pikën 10 të planit, por sidomos me pjesën e aneksit të planit (ende jozyrtare), Kosovës i kërkohet formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe! Është mjaft i çuditshëm dhe shumë i rrezikshëm fakti se kryeministri i Kosovës qenka pajtuar me këtë plan. Qytetarët me plot të drejtë pyesin: ku mbetën 6 kushtet e kryeministrit tonë?! Ku mbeti njohja e Kosovës?! Ku mbeti reciprociteti në të drejta i veriut të Kosovës me Luginën?! Apo të gjitha këto janë vetëm për konsum të brendshëm e për manipulim të qytetarëve!?. Lëvizja për Bashkim është pa dyshimin më të vogël kundër miratimit të këtij plani. Ky plan, së bashku me asociacionin dhe autonominë për serbët, të kamufluar në brendësi të planit, paraqet një të keqe të madhe dhe afatgjatë për Kosovën”, theksohet në reagimin e LB-së.

## Kurti mori pjesë në punëtorinë e drejtuesve të agjencive të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

PRISHTINË, 1 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ishte pjesë e punëtorisë së drejtuesve të agjencive të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Aty ai shprehu falënderimin për mbështetjen e vazhdueshme ndër vite ndaj

Kosovës dhe për bashkëpunimin e deritanishëm dhe shprehu gatishmërinë që ky raport të vazhdojë edhe me tej. Kryeministri Kurti veçoi bashkëpunimin ndërmjet qeverisë dhe agjencive të Kombeve të

Bashkuara në disa fusha kyçe me interes të përbashkët, si ajo e zbatimit të Planit Kombëtar të Zhvillimit, reagimit ndaj vërshimeve dhe realizimit të projektit të regjistrimit të popullsisë.



# Hyn në fuqi Ligji i ri gjerman për Zinxhirët e Furnizimit, prek edhe kompanitë nga Kosova

PRISHTINË, 1 MARS - Nga 1 janari 2023 në Gjermani ka hyrë në fuqi Ligji i ri për Konsideratë të plotë në Zinxhirët e Furnizimit që prek edhe kompanitë nga Kosova që punojnë me partnerët nga ky vend. Sipas njoftimit të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK), ky ligj synon të krijojë një ambient që mbrohet të drejtat e kompanive që përfshihen në zinxhirin e furnizimit.

“Me këtë ligj mbrohen standardet themelore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe ndëshkohen shkeljet e të drejtave të njeriut, si puna e fëmijëve, puna e detyruar dhe diskriminimi, mbrojtja në vendin e punës, liria e asociimit dhe e shoqërimit dhe paga e arsyeshme. Nëse rreziqet mjedisore çojnë në shkelje të të drejtave të njeriut (përmes ujit të ndotur), përfshihen gjithashtu ndotja e ajrit dhe



ujit, si dhe përdorimi i kimikateve dhe pesticideve ose shpyllëzimi i paligjshëm, kompanitë do të sanksionohen me një nga këto masa: gjoba deri në tetë milionë euro ose deri në dy për qind të shitjeve vjetore ose përjashtim nga prokurimi

publik për shkelje të rënda deri në tre vjet”, ka njoftuar OEGJK-ja.

Ajo që mund të pritët për kompanitë në Kosovë është se mund t'u vijë kërkesa për auditim dhe kontrata të reja që parashohin rregullat që përcakton ky ligj. Gjithashtu, duhet të jetë e qartë që edhe pse Kosova nuk është në BE, kompanitë gjermane janë. Dhe për të mbrojtur veten në rast të hapjes së ndonjë procedure gjyqësore, ato do të kërkojnë përgjegjësi nga kompanitë e Kosovës.

Ligji i ri për Konsideratë të plotë në Zinxhirët e Furnizimit në vitin e parë (2023) duhet të zbatohet nga kompanitë që kanë seli në Gjermani, përfshirë ato të huajat, dhe kanë më shumë se 3 000 punëtorë, kurse nga viti 2024 ligji do të zbatohet nga kompanitë me më shumë se 1 000 punëtorë.

## Çmimet vazhdojnë të bien ngadalë në Evropë

PRISHTINË, 1 MARS - Kryeekonomisti i Bankës Qendrore Evropiane, Philip Lane, ka thënë se presionet e inflacionit në eurozonë kanë filluar të lehtësohen, duke përfshirë çmimet thelbësore shumë të rëndësishme, por ky institucion nuk do t'i japë fund rritjes së normave derisa të jetë e sigurt se rritja e çmimeve po kthehet drejt dypërqindëshit. BQE-ja ka rritur normat me tri pikë përqindjeje që nga korriku dhe ka premtuar një rritje tjetër gjysmë përqindjeje në mars, me shpresën se financimet më të shtrenjta do ta pakësojnë kërkesën mjaftueshëm për ta ulur rritjen e çmimeve nga nivelet ende mbi 8 për qind. Lane tha se normat më të larta të interesit po funksionojnë në rrugën e tyre përmes ekonomisë, duke rënduar mbi çmimin e shërbimeve dhe mallrave të tjera thelbësore, të



cilat përjashtojnë karburantin dhe produktet ushqimore. Ai sqaroi se ka prova të

rëndësishme që politika monetare po fillon të ngjitet lart. Ndërsa për energjinë,

ushqimin dhe mallrat, ka shumë tregues largpamës që thonë se presionet e inflacionit

në të gjitha këto kategori duhet të ulen mjaftueshëm. “Banka ka nevojë për projeksione më të ulëta të inflacionit në horizontin e saj të parashikimit trevjeçar dhe për të bërë përparim në uljen e inflacionit aktual themelor. Së fundi, duhet të konkludohet se politika monetare po funksionon”, sqaron Lane.

I pyetur se sa gjatë mund të qëndrojnë normat në një territor që kufizon rritjen ekonomike, Lane tha se mund të jetë një periudhë mjaft e gjatë, një numër i mjaftueshëm tremujorësh.

Tregjet presin që norma e depozitave prej 2.5-përqindësh të BQE-së të rritet në gati 4 për qind deri në fund të vitit, me vlerësimin e normës maksimale të rritur me rreth 35 pikë bazë vetëm këtë muaj, kryesisht për shkak të frikës se inflacioni bazë ka ngecur.

## Ministri Peci merr pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Bujqësisë SIA2023

PARIS, 1 MARS - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, me ftesë të homologut të tij francez, ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Marc Fesneau, po qëndron për vizitë zyrtare në Paris, me rastin e hapjes së Panairit Ndërkombëtar të Bujqësisë - #SIA2023. Me këtë rast, ministrat e dy vendeve zhvilluan një takim të frytshëm, ku u dakorduan që bashkëpunimin mes dy shteteve ta zyrtarizojnë edhe

përmes një memorandumit të bashkëpunimit me qëllim të shkëmbimit të përvojave rreth digjitalizimit të sektorit bujqësor, ngritjeve të kapaciteteve në blegtori dhe verëtari.

Në anën e tij, në hapjen e panairit #SIA2023, ministri francez i Bujqësisë dhe Ushqimit, Marc Fesneau, para të pranishmëve parafrazoi duke thënë se “Për ta vlerësuar qeverinë e një vendi, duhet parë se sa afër ajo u qëndron

fermerëve!”.

Ministri i BPZHR-së, Faton Peci, zhvilloi takime edhe me figura të larta zyrtare, si ministrin e Bujqësisë së Luksemburgut, deputetë të Parlamentit Francez e atij Evropian, si dhe udhëheqës së dy instituteve bujqësore më me në zë në Evropë.

Njëkohësisht, ministri Peci e ftoi ministrin Fesneau që në të ardhmen ta vizitojë Kosovën dhe ta shohë nga afër potencialin që ka vendi ynë për zhvillim të sektorit.





# A duhet të kemi frikë nga papunësia teknologjike?



Nga Michael HAUSKELLER

Ka shumë gjëra që nuk ka më nevojë t'i bëjmë vetë. Tani për ne i bëjnë makinat. Sigurisht që sot ka ende shumë gjëra për t'u bërë nga ne njerëzit. Por nëse vazhdon kjo tendencë dhe makineritë që ndërtojmë po bëhen gjithnjë e më inteligjente, të sofistikuar dhe të fuqishme, atëherë ekziston një mundësi reale që ne të jemi më pak të nevojshëm për të bërë ndonjë punë.

Më pas puna e automatizuar e kryer nga makineritë, do të zëvendësojë përfundimisht të gjithë ose shumicën e punëve që kryeshin dhe ende sot nga ne. Nëse dhe kur kjo të ndodhë kjo gjë, atëherë do të kemi arritur një epokë të papunësisë teknologjike. Por a do të ishte diçka e mirë? A duhet ta mirëpresim këtë perspektivë apo duhet ta kemi frikë?

Në pamje të parë, papunësia teknologjike është një perspektivë joshëse. Sepse praktikisht do të thoshte që nuk do të duhej të punojmë më për të fituar jetesën. Do të kishim gjithçka që na nevojitet dhe e duam, pa pasur nevojë të shpenzojmë kohë për aktivitete që nuk duam t'i bëjmë vërtet, sepse për gjithçka do të kujdeseshin makineritë.

Sepse aktualisht shumë njerëz janë të pakënaqur me llojin e punës që bëjnë. Edhe nëse jemi me fat që të

bëjmë diçka për jetesën që na pëlqen, dhe do ta bënim atë edhe nëse nuk do paguheshim, zhdukja e nevojës për të punuar dhe për të shitur punën dhe aftësitë tona, është me siguri një gjë e mirë.

Sepse do të ishim plotësisht të lirë të zgjedhim çfarë të bëjmë dhe çfarë jo. Por nga ana tjetër është argumentuar me të drejtë se nëse nuk jemi të kujdesshëm, papunësia teknologjike nënkallë të lartë, mund të dëmtojë aftësinë tonë për të pasur një jetë kuptimplotë.

Dhe për ta parandaluar këtë duhet të zhvillojmë llojin e duhur të teknologjisë, dhe të lidhemi me të në mënyrën e duhur. Këtu problemi është se në një epokë të papunësisë teknologjike, makineritë do të na kenë zënë vendin dhe zëvendësuar si prodhues të vlerës. Më pas ato do të krijojnë të gjitha gjërat e mira, dhe do ta bëjnë botën një vend më të mirë, ndërsa ne do të jemi thjesht vëzhgues dhe përfitues pasivë.

Prandaj, në rast se duam të parandalojmë humbjen e kuptimit të jetës, ajo që duhet të bëjmë është të shmangim delegimin e punës dhe në vend të kësaj të ndjekim integrimin më të madh, gjë që do të thotë se në vend se ta përdorim teknologjinë, duhet ta integrojmë drejtpërdrejt atë në trupin tonë.

Megjithatë, mua më duket se rritja e papunësisë teknologjike nuk do të ishte domosdoshmërisht një problem edhe nëse nuk bëhemi sajborgë. Arsyja pse papunësia

është shpesh kaq shkatërruese për ata që e përjetojnë, është se ajo vjen zakonisht me një humbje të një të ardhure të mirë, humbje të lidhjeve shoqërore, dhe pasjen e një bollëku kohe të lirë me të cilën ata nuk janë mësuar (ose tani duke qenë të papunë nuk kanë mjete për ta shfrytëzuar si duhet) që ta përdorin sa më mirë.

Nëse keni pak mjete për të jetuar, njerëzit ju shohin me keqardhje ose përbuzje, dhe nuk keni asnjë idenë se si t'i mbushni orët e gjata të ditës, ndaj mund të justifikoheni për humbjen e motivit për të jetuar. Megjithatë papunësia teknologjike është e ndryshme: supozohet se nuk do të pësojmë humbje të të ardhurave apo humbje të njohjeve sociale (tek e fundit, të gjithë do të jemi në të njëjtën situatë).

Ne thjesht nuk do të kemi nevojë të punojmë. Pa dyshim, mund të zbulojmë se kemi shumë kohë në dispozicion, por kjo është kryesisht një çështje e zhvillimit të mendësisë së duhur. Nuk ka asnjë provë që në epokën tonë të papunësisë parateknologjike, ata që i përkasin të ashtuquajturës klasë që ka shumë kohë së lirë, e shohin jetën e tyre si më pak kuptimplotë sesa ata që në fakt duhet të punojnë për të siguruar jetesën.

Nëse jeni i pasur, nuk ka gjasë të kërkonti dëshpërimisht një punë, vetëm për të pasur diçka për të bërë. Nëse nuk ju është dashur të punoni ndonjëherë, atëherë nuk do t'iu

mungojë puna. Do të dini se çfarë të bëni me kohën tuaj, dhe nuk do të ndjeni atë që shpesh ndiejnë ata që kanë humbur punën: humbjen e ndjenjës së qëllimit në jetë.

Ju mund të mos jetoni një jetë veçanërisht kuptimplotë (nëse me kuptim kuptohet kërkimi i një lloji lidhjeje dhe ndjekje aktive e asaj që është në të vërtetë e vlefshme në jetë), por ata që janë në punë mund të mos e bëjnë këtë. Çështja është se të pasurit nuk duket se kanë më shumë gjasë të bëjnë një jetë të pakuptimtë se sa cilido tjetër.

Ose mendoni për pensionin. Njerëzit dalin në pension nga puna. Disa e presin me padurim, të tjerët e kanë frikë, por shumica gjejnë një mënyrë për t'u përballur me atë fazë të jetës. Sigurisht, mund të duhet pak kohë për t'u mësuar me ndryshimin, sidomos nëse nuk keni njohur kurrë një jetë pa punë.

Meqenëse e gjithë jeta jonë organizohet zakonisht rreth punës, ne priremi ta përcaktojmë veten përmes saj. Kur dalim në pension, duhet të mësojmë të përcaktojmë veten ndryshe, dhe të zhvillojmë një mentalitet ndryshe. Ndoshta nuk është e lehtë, por jo e pamundur. Nëse ose kur të na prekë epoka e papunësisë teknologjike, do të duket sikur i gjithë njerëzimi në tërësi do të dalë në pension.


Por kjo nuk do të ndodhë brenda natës. Me shumë mundësi, ne do të ecim gradualisht drejt saj, ndaj do të mësojmë të jetojmë me rrethanat

që ndryshojnë. Por a do të na mbetej diçka për të bërë? Në një epokë të papunësisë teknologjike, makineritë mund të përfundojnë duke bërë të gjitha gjërat interesante, gjithçka që mund të gjenerojë kuptim për dikë, pra ai që i bën ato, ndërsa ne njerëzit do të reduktoheshim në spektatorë të thjeshtë.

Kush e di, edhe ky artikull mund të shkruhet nesër nga një makineri. Megjithatë, kuptimi nuk është prerogativë e agentëve. Edhe vetëm duke vëzhguar dhe përjetuar botën dhe atë që po ndodh në të, mund të jetë shumë shpërblyese. Ne mund të gjejmë kuptim në leximin e librave të njerëzve të tjerë, studimin e pikturave të njerëzve të tjerë dhe dëgjimin e muzikës së njerëzve të tjerë.

Mund të gjejmë kuptim duke u endur nëpër një peizazh që nuk e kemi projektuar, dhe duke notuar në një det që nuk e kemi krijuar. Atëherë pse nuk duhet të jemi në gjendje të gjejmë kuptim në arritjet e makinerive që kemi ndërëtuar? Me mentalitetin e duhur, nuk është i nevojshëm integrimi njeri-makinë. Më e mirë do të jetë ndarja e vazhdueshme midis tyre.

*Shënim: Michael Hauskeller, profesor i filozofisë dhe Shefi i Departamentit të Filozofisë në Universitetin e Liverpulit, Angli. / "Daily Philosophy" – Bota.al*



Veton Zymberi, redaktor i sportit

## Kuka: Putini u revoltua me fitoren e Majlinda Kelmendit

**TRANË, 1 MARS** - Driton Kuka është trajneri shqiptar që qëndron pas ikonave të xhudos që na kanë bërë krenarë të gjithëve në botë, nga Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi, Nora Gjakova etj. Ai ka vendosur që këtë punë përgjatë gjithë këtyre viteve ta ndajë me të gjithë përmes një libri për jetën e tij, ku padyshim nuk kanë munguar as episode të rëndësishme. Në një lidhje me "Skype" për "ABC e Mëngjesit", Kuka ka treguar për fitoren e Kelmendit në Rusi, ku edhe presidenti Putin u revoltua. "Fillimisht duhet cekur që kemi pasur shumë pengesa në shumë shtete që nuk e njohin realitetin e shtetit të ri të Kosovës. Faktikisht, me rezultatet që ka arritur në fillim Majlinda, në një farë forme ajo e ka shtyrë këtë qasje. Unë kam thënë që rezultatet e Majlindës, përveç në dimensione sportive, kanë shkuar përtej, kanë ndërtuar

diçka tjetër. Sepse Majlinda ka triumfuar në shtetet të cilat nuk e njohin Kosovën dhe në të cilat normalisht klasa politike nuk mund as të duket. Fitorja e Majlindës në Rusi ka qenë diçka e jashtëzakonshme sepse është revoltuar e gjithë klasa politike atje, deri te presidenti Putin. Emri i saj ka qenë i lakuar në të gjitha instancat ndërkombëtare politike si Kombet e Bashkuara, Parlamenti Evropian etj. Edhe faktikisht është mirë sepse ne kemi bërë zhurmë pse nuk po na lejohet, po në anën tjetër Majlinda bashkë me mua si trajner e kemi kryer punën në mënyrën më të mirë të mundshme në terren, sepse kemi bërë shumë zhurmë dhe, në anën tjetër, në olimpiadën e parë në Rio kemi arritur ta fitojmë medaljen e arit", rrëfeu ai.

Më tej, i pyetur se pse gjithmonë vajzat shqiptare dominojnë në këtë sport, Kuka



u shpreh: "Unë po e them sinqerisht që vajzat shqiptare kur kanë një qëllim, ato e arrijnë. Dmth., janë shumë

këmbëngulëse, shumë punëtore. Ndërsa te meshkujt kur vjen ajo moshë e rinisë, diku 18-19 vjeçarët është pak

më problem dhe jeta e tyre merr një kahe ndryshe dhe nuk është lehtë me i menaxhu".

## Muriqi: Dua ta ndihmoj Spanjën të na njohë si shtet

**MALLORCA, 1 MARS** - Vedat Muriqi, futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës dhe Mallorcas, pak ditë më parë është nderuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës me "Çmimin Special 2022" në ceremoninë e Laureatëve. Me anë të një videomesazhi, Muriqi në ceremoni bëri një deklaratë e cila ka bërë bujë në mediet

spanjolle. "Me këtë fuqi dhe kurajë që kam, shpresoj ta ndihmoj shtetin tim, që Spanja një ditë të na njohë edhe si shtet", ka deklaruar Muriqi. Mediumi i madh spanjoll "Mundo Deportivo" i kushtoi një artikull të veçantë deklaratës së Muriqit. "Muriqi: 'Dua të ndihmoj Spanjën të na njohë si

shtet", shkruhet në titullin e artikullit të mediumit spanjoll. 28-vjeçari nga Prizreni është pjesë e Mallorcas që nga vera e vitit të kaluar, ndërsa ka "shpërthyer" këtë edicion duke shënuar 10 gola. Muriqi është ndër futbollistët më të rëndësishëm të ekipit ishullor që bën gara në La Liga.



## Tate, MVP i javës në Superligë



**PRISHTINË, 1 MARS** - Java e 23-të në Prince Caffè Superligë dhuroi disa sfida interesante. Peja fitoi bindshëm ndaj Ponte Prizrenit, ndërsa më i miri në parket ishte Jalen Tate me 29 pikë, tri kërcime dhe dy asistime. Tate ishte më i miri i ndeshjes dhe i javës, duke qenë

hera e parë që në këtë edicion shpallet MVP i javës. Ai u ndihmua nga qendra Brad Waldow që shënoi tetë pikë, por kishte edhe 20 kërcime e gjashtë asistime. Sigal Prishtina triumfoi në derbin ndaj Golden Eagle Yllit, ku më i miri ishte Dardan Berisha. Kapiteni i

Kosovës ishte bindshëm lojtari më i mirë i kësaj sfide me 27 pikë, katër kërcime dhe pesë asistime. Trepça ka vazhduar me formë të mirë, për ta regjistruar fitoren e radhës ndaj Bashkimit, ku u dallua Ken Brown me 23 pikë, tri kërcime dhe gjashtë asistime.

## Kosova mposhtet edhe nga Italia

**PRISHTINË, 1 MARS** - Përfaqësuesja U17 e Kosovës në hendboll (vajzat) e ka luajtur të mërkurën ndeshjen e fundit në fazën grupore në Kampionatin e 16 Mesdhetar. Kosova U17

humbi nga Italia me rezultat 20:15. Sërish vajzat tona e hapën ndeshjen shumë mirë, duke e fituar periodën e parë me rezultat 5:4. Perioda e dytë u takoi italianeve, 9:4, ndërsa e fundit ishte e barabartë. Por

në fund Italia fitoi 7:6 dhe e fitoi ndeshjen me rezultat 20:15. Loja e Kosovës, megjithatë, është duke u përmirësuar vazhdimisht dhe më shumë pritjet në dy ndeshjet e fundit. Të enjten pasdite

Kosova U17 luan me Tunizinë, ndërsa të premten e ka ndeshjen e fundit me Italinë. Këto dy ndeshje janë për plasman përfundimtar. Kampionati Mesdhetar po zhvillohet në Nafplio të Greqisë.



## Tottenhami, marrëveshje bashkëpunimi me Formulën 1

LONDËR, 1 MARS - Tottenham Hotspur dhe Formula 1 kanë nënshkruar një marrëveshje 15-vjeçare bashkëpunimi. Klubi anglez dhe "circus" tashmë janë partnerë në projektin më të ri mes futbollit dhe motosportit, disiplinë që

do t'i bashkojë stadiumi i ri modern në Londër. Kështu, marrëveshja mes palëve konsiston në shfrytëzimin e stadiumit për garat "kart" elektrike me pistën "indoor" që do të improvizohet në terrenin e stadiumit dhe do të

jetë më e gjata në Londër. Ky është shembulli më i fundit që tregon se tashmë arenat moderne janë multifunksionale, duke përfshirë një gamë të gjerë sportesh dhe ngjarjesh. Por për sa i përket bashkëpunimit

mes futbollit dhe automobilizmit, përvoja e këtij lloji është një risi në stadiumet evropiane. Do të ketë pista të ndara "karting" për të rritur dhe fëmijë, por gjithashtu mbahen edhe gara motoçiklizmi.



## Kupa e Mbretit sjell 'El Clasico'-n

MADRID, 1 MARS - Sonte (e enjte) zhvillohet "El Clasico" mes Real Madridit dhe Barcelonës, në kuadër të gjysmëfinalës së Kupës së Mbretit. Kjo ndeshje zhvillohet në "Santiago Bernabeu" nga ora 21:00. Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, është shprehur i lumtur se skuadra e tij është ende në garë në të gjitha frontet, anë pse Barcelona është ende larg në ligë. Strategu italian është optimist se skuadra e tij mund të fitojë të gjithë trofetë. "Deri më tani kemi dy pikë më pak në ligë se vitin e kaluar, por nuk kishim arritur në gjysmëfinalen e Kupës së Mbretit dhe kishim humbur ndeshjen e parë të raundit të 1/16 të Ligës së Kampionëve. Jemi aty ku e meritojmë dhe tani vjen pjesa më e bukur, momenti më i rëndësishëm i sezonit. Mendoj se mund të fitojmë ende, por unë nuk jam magjistar", ka thënë Ancelotti.

Në anën tjetër para "El Clasico"-s foli edhe trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, i cili tha se Real



është favorit në këtë ndeshje. "Është një mundësi e shkëlqyer për të fituar një titull. Ne e dimë se Real është rival i vështirë, por qëllimi ynë është të fitojmë. Mendoj se gjithçka do të vendoset pas kthimit në 'Camp Nou'. Real vazhdon të jetë

favorit. Është kampion në fuqi në Spanjë dhe në Evropë. Ne shkojmë në Bernabeu me entuziazëm dhe dëshirë. Gjithmonë më motivon të shkoj në Bernabeu. Ne duam të përiqemi të jemi protagonistë në Real Madrid", ka thënë Xavi.

## Milwaukee arrin 15 fitore radhazi, Denveri nuk lëshon kreun në Perëndim

HOUSTON, 1 MARS - Fitorja e pesëmbëdhjetë radhazi në kampionat për Milwaukee, që mposhti me rezultat 118-104 Brooklynin jashtë fushës dhe konfirmohet si ekipi më i mirë në Konferencën e Lindjes. Giannis Antetokunmpo realizoi 33 pikë e 15 rebounde në rikthimin e tij në fushë, duke i bërë të pavlefshme 31 pikët e Bridges për vendasit. Pa LeBron Jamesin skuadra e lakersave nuk arrin të fitojë, duke u mundur



me rezultat 121-109 nga Memphis. Anthony Davis realizoi 28 pikë e 19 rebounde, por që s'mjaftuan. Për Memphisin shkëlqeu Ja Morant, autor i një "triple double", me 39 pikë, 10 rebounde e 10 asistime. Fiton edhe ekipi kampion i Golden State, që falë 29 pikëve të Jordan Pooles mundi me rezultat 123-105 Portlandin. Humbja e dytë radhazi për

Dallasin, që u mund me rezultat 124-122 nga Indiana, ndeshje e vendosur në fund nga Haliburton, autor i 32 pikëve për miqtë. Për Dallasin u dallua Luka Doniqi me 39 pikë, por që mbetën për statistikë. Në krye të renditjes në Perëndim qëndron skuadra e Denverit, që mposhti me rezultat 133-112 Houstonin, ndeshje ku Jamal Murray realizoi 32 pikë për Nuggetsin.

### REZULTATET

Atlanta - Washington	116-119
Brooklyn - Milwaukee	104-118
Memphis - Lakers	121-109
Toronto - Chicago	104-98
Houston - Denver	112-133
Oklahoma - Sacramento	117-123
Dallas - Indiana	122-124
Utah Jazz - San Antonio	94-102
Golden State - Portland	123-105
Clippers - Minnesota	101-108

## Ndërron jetë legjenda Just Fontaine

Bota e futbollit po vajton për humbjen e legjendës së Francës, Just Fontaine, pasi familja e tij njoftoi për vdekjen e tij në moshën 89-

vjeçare. Fontaine mbetet mbajtësi i rekordeve për më shumë gola të shënuara ndonjëherë në një Kupë Botërore të vetme. Francezi

shënoi 13 herë në gjashtë ndeshje për Les Bleus në turne në vitin 1958, shkruan "Goal". Ish-sulmuesi lindi në Marrakech, në atë kohë

pjesë e Marokut francez dhe filloi karrierën e tij me USM Casablanca para se të kalonte në Nice dhe më pas Reims.



### SHKURT

#### Galatasarayt ofron 5 milionë euro për Rashicën

Milot Rashica e ka bindur Galatasarayn me paraqitjet e tij. Reprerentuesi i Kosovës, Milot Rashica, po shkëlqen me Galatasarayn dhe kjo ka bërë që klubi turk të përgatitë ofertë për anësorin nga Vushtrria. Në fakt, Rashica është huazuar nga Norwich City te Galatasaray. Mediumi "Fanatik" raporton se skuadra e madhe turke ka vendosur ta bëjë futbollistin "dardan", për të cilin ka përgatitur një ofertë prej 5 milionë eurosh. Rashica ka luajtur edhe për Werder Bremenin në Bundesliga.

#### Martinezi, synim i Arsenalit

Sulmuesi Lautaro Martinez mund ta bartë fanellën e Arsenalit nga vera. Pos Chelseat dhe Manchester Unitedit, tani janë "Topçinjtë" që kanë shprehur interesim në sulmuesin e Interit. Është trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta që, sipas "Vis Fichajes", e do argjentinasin në skuadër. Argjentinasi mund të luajë edhe përkrah Gabriel Jesus.

#### Unitedi në verë e dëshiron Osimhenin ose Kanen

Manchester Unitedi është duke përformuar mirë në Premierë Ligë, derisa e ka fituar edhe Carabao Cup. Ky klub në afatin kalimtar të verës pritet të përforcohet në fazën e sulmit, njofton "Manchester Evening News". Ndërsa dy emrat që po lakohen aktualisht janë sulmuesi i Napolit, Victor Osimhen dhe Harry Kane i Tottenham Hotspurs.

#### Hamiltoni: Te Mercedesi të gjithë po punojnë fort

Sezoni 2023 në Formula 1 do të jetë i vështirë për Mercedesin, që sërish nuk është në nivelin e Red Bullit apo Ferrarit. Madje edhe Aston Martin duket një hap përpara makinës gjermane. Testet në Bahrein treguan se Mercedesi ka ende punë për të bërë dhe se makina gjermane është ende gjysmë sekonde më e avashtë se rivalët.

Lewis Hamilton shpjegoi vështirësitë e ekipit të tij në fillim të sezonit, por shtatë herë kampioni i botës ka besim te Mercedesu: "Të gjithë e kanë ulur kokën dhe po punojnë, ndaj unë jam vërtet krenar për këtë. E di se të gjithë në fabrikë do t'i analizojnë këto të dhëna dhe do të vazhdojnë të punojnë me to. Testet ishin mjaft interesante edhe pse nuk është kurrë e lehtë. Ajo që më befason këtë sezon, i 11-ti për mua te Mercedesi, është se të gjithë kanë ardhur me të njëjtin mentalitet, duke punuar shumë. E kuptojmë se kemi një mal për të ngjitur, por askujt nuk i intereson", ka shtuar Hamiltoni.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “2ADVANCED” L.L.C. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811976705 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavje se svi klienti da drustvo sa “2ADVANCED” L.L.C. Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811976705 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “2ADVANCED” L.L.C.. with headquarters Mitrovicë, has come to the decision to quit its business: 811976705 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
 Qeveria - Vlada-Government  
 Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom / Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

**Ftesë për Ankand Publik**

**Datë 01.03.2023**

**Referenca: AAPSK – 002/2023**

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	VW Golf III,viti i prodhimit 1992,benzin, ngjyre teget metalike, me targa vendore-Rishpallje	1 copë-Rishpallje	700.00.€		
2	Renault B/C40, dizel, ngjyre e hirit,- për skrap	1 copë/për skrap	143.60€		
3	Furgon VW 253, dizel,ngjyre e bardhë-për pjesë	1 copë/për pjesë	500.00€		
4	VW Golf II, benzin, ngjyre e zezë-për pjesë	1 copë/për pjesë	250.00€		
5	VW Golf II, benzin, ngjyre e bardhë-për pjesë	1 copë/për pjesë	250.00€		
6	VW Golf II, benzin, ngjyre e zezë-per pjese	1 copë/për pjesë	250.00€		
7	VW Passat Karavan, benzin, ngjyre e kuqe- per pjese	1 copë/për pjesë	300.00€		
8	VW Golf II, benzin, ngjyre e kuqe-për pjesë	1 copë/për pjesë	250.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më 08.03.2023 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 08.03.2023, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se ,në: <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 051



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook [www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Auto Shkolla “Trimi” në Gjilan, njofton kandidatët e interesuar për regjistrimin e patentë shoferit se për nder të festave të muajit mars bënë zbritje në pagesë.
- Skender Shotka shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- Senahid Bytyqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfm " Abdyl Frasher " Prizren.
- Jeton Berisha shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- Florim Aliaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfm " Dy Dëshmorët " Pirane.
- Vlora Musa nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Shkrije Xharra nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Melisa Malaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shfm Ulët “Selman Riza” Piskot Gjakovë nga kl. VI-IX.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## PASHTETË PULE

MEKA  
HALAL FOOD

gluten  
free



cilësi e garantuar

pa konservues